

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
ADMINISTRACIONE E FUSHË-KOSOVËS - ADMINISTRACIONE E KOSOVO-POLJE

Gratë/Best: 110
Data/Date: 26.07.2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së pestë - V - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 08.06.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Ilir Hasani, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Graiçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Fatlum Berisha - Udhëheqës i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Besnik Hykolli - Udhëheqës i Drejtorisë së Inspektoratit dhe Antigona Sahiti — Shefe e Planifikimit Urban.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.04.2021.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e kërkesës Nr. 01-104/02-0012784/21, për këmbimin e pronave në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afaristë sh.p.k 'Arbotec', për palën Hektor Beqiri.
4. Propozim për ndarjen e pagesave në këste të taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë.
5. Propozim për marrjen e vendimit për fillimin e procedurës për themelimin të dy institucioneve të arsimit parauniversitar në Fushë-Kosovë.
6. Propozim për vendosjen e një kontejneri në hapësirën e parkingut në oborrin e komunës për Postën e Kosovës.
7. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për këtë mbledhje.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.04.2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.04.2021, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne jemi kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit, meqë për tre vite me radhë nuk ka ndodhur publikimi i audioincizimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kjo nuk është bërë po ashtu, as nga muaji janar i vitit 2021, që ka qenë edhe premtim publik në media i Kryetarit të Komunës. Vërejtje në përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit ne nuk kemi.

Pasi që diskutime tjera nuk pati lidhur me përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.04.2021.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 29.04.2021.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtronë pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do ta parashtroi një pyetje tani për Nënkryetarin e Komunës, lidhur me projektin për vendosjen e shiritit të kuq për çiklistë në të dy anët e brezit të rrugës 'Nëna Terezë', që ka kushtur 40,000.00€, për këtë projekt shkel e shko kanë shkruar edhe portalet, vendosja e këtyre shiritave nuk është bërë si duhet, aty janë të rrezikuar këmbësorët, sepse shpejtësia e automjeteve është 60km në orë, nuk është e qëlluar as vendosja e zebrave në disa vende në hapësira jo të largëta për kalim të këmbësorëve, pa asnjë shënjë të komunikacionit, sepse aty automjetet që vijnë nga qytetet tjera nuk dinë, shpejtësia e lartë i rrezikon këmbësorët. Për Drejtorinë e Inspektoratit e kam një pyetje, për ndërtimet që po bëhen në parkun e pishave, ju keni theksuar se me një vendim të Kryetarit të Komunës këto ndërtime janë ndaluar, por atje ndërtimet e villave në fshatin Pomozotim po vazhdojnë për ditë. Për veprimtarinë

e lokaleve tek Stadiumi i Futbollit, ku po zhvillohen dukuri negative, ka prostitucion aty, kjo ka qenë edhe në media të shkruara, ka patur edhe ankesa të qytetarëve të zonës në fjalë, por nuk ka asnjë ndryshim dhe reflektim nga institucionet. E fundit Shefi i Prokurimit Bedri Obërtinca, e përdor automjetin zyrtar të komunës në orën 24:00h, andaj unë pyes, pse menaxhmenti i komunës nuk ndërmerrë asnjë masë ndëshkuese dhe disiplinore ndaj këtij zyrtari?

Durim Hajra: Në fakt, unë duhet t'i përsëris tani disa pyetje, për të cilat nuk kemi marrë përgjigje, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, lidhur me menaxhimin e mbeturinave, në rrugën '28 Nëntori' afër Qendrës së Mjekësisë Familjare, kontejnerët aty ka kohë që janë të mbingarkurë, mbeturinat nuk mirren me kohë, ka ankesa të qytetarëve për këtë fenomen që është bërë i zakonshëm tani nga mosveprimi, ne kërkojmë që të mirren masa konkrete për ndryshimin e gjendjes aty. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban e kam një pyetje lidhur me rrethrotullimin tek pompa Kastrati, pas takimit me përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës, pyes cilat janë veprimet tjera lidhur me këtë punë. Cili është vlerësimi për ndikimin e këtij rrethrotullimi nga ekspertët, që janë duke e hartuar 'Planin e Mobilitetit', për rregullimin dhe shkarkimin e komunikacionit në qytetin tonë. Kur do të ndërtohet rruga 'Imer Sfarqa' që e lidh fshatin Lismir me qytetin, sepse kjo rrugë është e dëmtuar. Po ashtu kemi shqetësim dhe ankesa të qytetarëve dhe bizneseve, edhe për ndotjen akustike, ndërsa në anën tjetër nuk kemi asnjë gjobë të shqiptuar nga Inspektorët Komunal për këtë problem. Për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit e kemi një pyetje, cilat janë planet dhe a parashihen investime këtë vitë në stadiumin e qytetit, si dhe kërkojmë që të punohet në rregullimin e statusit të pronës për stadiumin e qytetit tonë. Pyetja tjetër ka të bëjë me bursat apo ndihmat për student, pse po vonohet shpërndarja e tyre. Po ashtu njëjtë kërkojmë, që të mos vonohet ndihma dhe kompensimi për familjet e prekura nga vërshimet në muajin janar 2021. Në fund pyetja jonë që përsëritet në vazhdimësi, furnizimi me ujë 24 orë nëpër fshatra, si dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit kur do të realizohet si projekt jetikë për qytetarët?

Ilir Hasani: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Edhe unë e kam pyetjen e njëjtë me anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, si do të vepohet me trajtimin e villave që po ndërtohen në zonën e pishave? Cilat janë veprimet e Inspektoratit të Komunës, që do të ndërmerren për mbrojtjen e zonës pyjore atje. Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kërkojmë që të menaxhohen më mirë mbeturinat, ju e dini që Fushë-Kosova tani është një qytet në zhvillim dhe duhet një trajtim më specifikë i ambientit, në zona të caktuara, zgjerim i kapaciteteve të operimit nga Kompania 'Pastrimi', duhet të mirëmbahen parqet dhe rrugët nëpër fshatra, edhe bizneset duhet të pastrojnë vetë hapësirat para lokaleve të tyre.

Aida Alimi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që të ndërmerren veprime konkrete për eliminimin e dukurive negative, që po zhvillohen në lokalet afër Stadiumit. Njëherit kërkoi që të aktivizohet dhe të fillon punën Grupi Punues për emërtimin e rrugëve, vjet jeni arsyetuar se jemi në kohë të pandemisë, por kjo punë është neglizhur mjaftë pa ndonjë arsyetim të bazuar.

Driton Ademi: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë dua ta shtroi tani këtu një shqetësim që është ndërlidhur edhe me partitë politike dhe kundërshtimet ndërmjet tyre, ku jam përmendur edhe unë lidhur me shkrime të ndryshme në media, këtu kemi të bëjmë me ndriçimin publik, ku

disa subjekte tjera politike kanë nxitur edhe zgjidhje tjera të pa pranueshme nga qytetarët, unë mendoi dhe kërkoi këtu veprimin e Policisë së Kosovës, gjetjen e keqëbërësve dhe dënimin e tyre.

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë në fillim të mandatit e kam theksuar problemin me mikrofonta, tani jemi në fund të mandatit dhe prapë e kemi këtë problem. Problemi tjetër që dua ta theksoi është ndriçimi publik në fshatin Bardh i Madh, ku ka shumë probleme edhe tani, si po duket pushteti aktual është në gjumë dimërorë, nuk ka asnjë veprim për rregullimin e problemeve. Po ashtu kam kërkuar prerjen e barit anash në rrugën Lismir/Bardh i Madh dhe Kuzmin/Bardh i Madh, sepse aty ka rrezik për qytetarët sepse nuk shihet nga bari i madh në të dy anët e rrugës.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kam një pyetje, kur do të filloni me trajtimin e qenëve endacakë që po paraqesin rrezik permanentë për sulme ndaj qytetarëve, ku mund të kemi edhe viktima, sepse numri i tyre është i madh nëpër rrugë. Pyes Kryetarin e Komunës, kur do të fillon funksionimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen e Dardanisë, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare më afër qytetarëve?

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kërkojmë sqarime për realizimin e projektit publikë të shtegut për çiklistë, sipas kontratës së prokurimit publikë? Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kërkojmë që në kryqëzimin e rrugës 'Pajazit Islami' me Hekurudhën, të hiqen mbeturinat e vendosura aty dhe të mos lejohet krijimi i deponive të egra të mbeturinave, sepse ardhja e trenit nuk po shihet dhe kjo paraqet rrezik për banorët e zonës.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu kemi të bëjmë me një pyetje elementare por shumë serioze, lidhur me ndërtimet në zonën e pishave në fshatin Sllatinë e Vogël dhe Pomozotin, ajo zonë atje është para degradimit, është përgjegjësi e pushtetit ta ruajnë këtë parkë, që po shfrytëzohet nga banorët e komunës tonë. Shtegu për çiklistë nuk është punuar me standarde dhe përveç rrezikut të madh për këmbësorët, është edhe i shëmtuar, nuk e plotëson asnjë rregull për lëvizjen e çiklistëve, vetë gjerësia e tij paraqet rrezikshmëri. Zona e denduar për qarkullim ku janë shkollat, kërkon një studim, komuna jonë sa i përket arsimit dhe banimeve kolektive është një rast sui-generis, e don një seriozitet të madh, jo një përgjegjësi totale kolektive si është tani ne veprimet që ndërmirren, pa plan dhe po thuaj se 'ad hoc', aty për aty.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes lidhur me tatimin në pronë të banesave në Fushë-Kosovë, a ekzekutohen pagesat nga objektet banesore dhe a ka evidenca të rregullta për tatime të banesave të shumta kolektive në Fushë-Kosovë?

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Po kemi evidenca dhe tatimi në pronë është burimi kryesor i financimit në komunë.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Po secili transaksion që bëhet regjistrohet në kadastër dhe pas regjistrimit të pronarit, subjekti i pronës private evidentohet në sistemin e tatimeve. Puna nga punëtorët tanë bëhet me mjete elektronike të punës - xhipi-es në mënyrë dixhitale.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në komunë nuk është duke u përfillur fare barazia gjinore, tani nuk e kemi asnjë Drejtoreshë në Komunë, tjetër raporti i performancës

për komunën tonë është shqetësues, nuk është i mirë duhet të përmirësohet puna dhe aktiviteti në shumë fusha. Unë vetë kam kërkuar që komuna të angazhohet dhe të marrë pjesë në grantet për energjinë efikente nëpër institucione publike, po ashtu të përkrahen gratë që mirren me biznes, të bëhen thirrje publike - njoftime edhe nëpër fshatrat tona.

Shaban Ademi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë kohën e fundit kam qenë i prekur me virusin Covid - 19, kam qenë në spital dhe në oksigjen, por dua të them se në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë, e kam parë një përkushtim të madh, që dua tani të vë në pah, të stafit të mesëm motrave medicinale, ato e bëjnë punën e tyre njësoi si në Norvegji e Gjermani nuk ndryshon fare asgjë, e kanë një angazhim maksimal në punë dhe meritojnë lëvdata, të përkrahen, të përmirësohen në vazhdimësi kushtet e punës për punëtorët shëndetësorë. Ato duhet të thirren në një ditë të caktuar, të përkrahen nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, të marrin nga një falënderim, sepse përkundër pagave të ulëta e kanë një angazhim dhe përkushtim në punë për çdo lëvdatë.

Nënkryetari i Komunës: Tani unë do të jap disa përgjigje në pyetjet e parashtruara, tenderi për shtegun e çiklistëve ka kushtuar 40,000.00€, ne mendojmë se puna në terren është kryerë në përputhje me shpalljen publike dhe pranohet nga një komision mbikëqyrës, po ashtu kalimet për këmbësorë janë kërkuar nga banorët dhe bizneset, shënjëzimi në këto vendkalime është dhe do ta rregullojmë edhe më tutje sipas rregullave, por të gjithë duhet ta dinë se kur hyn në një zonë të qytetit, duhet të ngasin veturat e tyre me kujdes të shtuar. Lidhur me ndërtimet në parkun e pishave, tani ajo zonë do të mbikëqyret edhe nga Inspektorët e Pylltarisë, është i hapur një debat publik nga data 21 maj deri me 21 qershor, kjo zonë do të jetë një zonë e mbrojtur. Ndërtimet aty janë pa leje, ato mund të rrënohen njësoi sikur ndërtimet në Prevallë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ju e dini këtë punë. Inspektorët tanë kanë dalur në terren kanë hartuar procesverbalet dhe lëndët procedohen në gjykatë. Për mbeturinat, në këtë punë përgjegjësinë e marrjes së mbeturinave nëpër lagje e ka Kompania 'Pastrimi', e cila është kompani profitabile, ne kemi punuar mjaftë shumë në shpërndarjen e kontejnerëve nëpër fshatra dhe në qytet, për t'iu dalur në ndihmë qytetarëve tanë dhe për të krijuar një mjedis të pastër. Lidhur me rrethrotullimin kjo punë ka filluar me ministrin e kaluar të Infrastrukturës, tani është ndërruar Qeveria dhe Ministri, nuk ka ndonjë zhvillim konkret, por kjo punë duhet të harmonizohet edhe me Komunën e Prishtinës dhe përgjegjëse në këtë proces, është Ministria e Infrastrukturës, këtë punë ne e kemi kërkuar për ta shkarkuar qytetin tonë nga numri i madh i automjeteve. Për rregullimin e statutit të pronave publike, për Stadiumin e qytetit ne e kemi dërguar lëndën në qeveri, ju e dini vendimin që e ka marrë ish/Kryeministri z. Ramush Haradinaj për kthimin e pronave shoqërore komunave, pastaj këtë vendim ish/Presidenti z. Hashim Thaçi, e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimi është shpallur i paligjshëm, të njëjtën punë të rëndësishme për ne si institucion, nuk e ka realizuar as ish/Kryeministri z. Avdullah Hoti. Furnizimi me ujë nëpër shumë zona në qytet ekziston, është rregulluar, për fshatin Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh, furnizimi me ujë do të mirret nga Korporata Energjetike e Kosovës, detyra jonë primare si komunë është shtrimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në terren dhe këtë punë ne e kemi bërë në vazhdimësi. Pagesat për vërshimet janë në proces e sipër dhe do të kryhen. Subvencionet në shëndetësi dhe arsim që në

fakt janë ndihma, këtë vitë e kemi një numër të madh të kërkesave dhe përfituesve dhe buxheti është i kufizuar. Ne e kemi menduar edhe çështjen e hapjes së Kompanie të re publike për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe parqeve, por procedurat për themelimin e tyre janë mjaftë të ndërlikuara. Mjetet financiare për personat e prekur me virusin Covid - 19, nuk janë të planifikuara me buxhet, deri tani janë mbi pesë mijë persona të infektuar, andaj kjo punë nuk mund të kryhet nga buxheti i komunës, nëse nuk ndahen mjete financiare shtesë nga Qeveria e Kosovës. Lidhur me problemin e ndriçimit publikë që është keqpërdorë nga disa subjekte politike, ne i kemi shkruar edhe Policisë së Kosovës, kemi kërkuar angazhimin e tyre dhe jemi në vëzhgim të këtij fenomeni të keq nga disa individë të caktuar, që po e dëmtojnë investimin e realizuar për qëllime tjera. Qendra e Mjeksisë Familjare në lagjen e Dardanisë, është e kompletuar për shërbime shëndetësore për Covid - 19 dhe do të përdoret për këtë qëllim në periudhën e ardhshme. Lidhur me barazinë gjinore, tani jemi në fund të mandatit, i kemi patur dy Drejtoresha të Komunës, ka drejtoresha në disa shkolla, e kemi Kryesuesen e Kuvendit të Komunës.

Ali Ismaili: Kjo punë është një pa përgjegjësi e njëmbëdhjetë Drejtorëve të Komunës, ne nuk kemi nevojë që të gjitha përgjigjet në mënyrë të përgjithësuar të jepen nga ju z. Nënkryetar i Komunës, nuk jemi të kënaqur me këto përgjigje, dhënia e përgjigjeve në këtë mënyrë nga ana juaj, është një guxim i madh, ju nuk keni kompetencë dhe detyra të punës të jepni përgjigje adekuate për secilin problem, që ngritet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Ne pyesim çka ndodh në terren me Inspektoratin e Komunës, sa gjopa janë dhënë, ju na thuani se lëndët procedohen në gjykatë.

Nënkryetari i Komunës: Falënderit për kritikën tuaj, unë e kam theksuar se këto janë përgjigjet në pyetjet e juaja, për përgjigje tjera konkrete, mund të përgjigjet secili drejtor me gojë ose me shkrim në mbledhjen e ardhshme.

Ali Ismaili: Unë për tetë vite këtu në dy mandate, nuk kam marrë asnjë përgjigje substanciale për pyetjet e mia të parashtruara, të natyrave të ndryshme, nuk jemi të kënaqur me këtë përgjigje të përgjithshme, pa kurfarë substance për çështjen e ngritur. Ne kërkojmë përgjigje konkrete për ndërtimet ilegale, në parkun e pishave në Sllatinë të Vogël dhe në Pomozotin, jo përgjithësim të problemit.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës Nr. 01-104/02-0012784/21, për këmbimin e pronave në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afaristë sh.p.k 'Arbotec', për palën Hektor Beqiri.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi 'Propozimin për këmbimin e pronës 00779-3 të subjektit afaristë 'Arbotec', me pronën fqinje 00002-0', në zonën kadastrale të fshatit Harilaç, për të cilën diskutimet janë zhvilluar në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën 29.04.2021, andaj e qesim në votim propozimin për këmbimin e pronave.

Migjen Kolshi: Së pari unë dua të sqaroj, që të mos kemi keqëkuptime, fjala është për këmbimin e 280 metrave katërorë pronë, ku unë nuk jam kundër, por procedura është e pa rregulltë kështu, këmbimi i pronave është i rregulluar me ligj shumë qartë, kur kemi të bëjmë me interesin publikë, ju njësoi keni vepruar edhe me 'Al Trade Center', por vendimi është kthyerë në rishqyrtim, ju lutem respektoni procedurat dhe ju znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, mos lejoni që secila

pikë e rendit të ditës të shqyrtohet, ju e keni pranë vetës juristin shumë të mirë dhe me përvojë, që ju jep sqarime.

Durim Hajra: Ju po theksoni se është shterrur debati, por në aspektin ligjor është se këtë punë e definon shumë drejtë, neni 24 dhe neni 25, ku duhet të jetë i shprehur interesi publikë, ne në parim jemi për, nëse respektohen të gjitha procedurat sipas ligjit.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për këmbimin e pronës 00779-3 të subjektit afaristë 'Arbotec', me pronën fqinje 00002-0', në Zonën Kadastrale Harilaç'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej të pranishëm shtatëmbëdhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për këmbimin e pronës 00779-3 të subjektit afaristë 'Arbotec', me pronën fqinje 00002-0', në Zonën Kadastrale Harilaç' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 289, të datës 20.04.2021, për këmbimin e sipërfaqës të barabarta të pronës me Nr. 00779-3, me pronën 00002-0, sipas vlerësimit të kryerë nga eksperti i vlerësimit të pronave si vijon:
 - 1.1 Sipërfaqja e pronës së dhënë në shfrytëzim për 99 vite prej S=281m², në pronësi të Istref Sejdi Elshani dhe Hektor Elez Beqiri, pjesë e ngastrës kadastrale të evidentuar certifikatën e pronës me Nr. P-72514003-00779-3, me sipërfaqe të përgjithshme të saj prej S=00.02.81 ha, arë e klasës së pestë, në vendin e quajtur 'Shume Krivovo', me status ligjor e pa ngarkuar me hipotekë, në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afarist 'Arbotec', me numër identifikues të biznesit 810533879, këmbëhet me pronën në sipërfaqe prej 281m², pjesë e ngastrës kadastrale të evidentuar në certifikatën e pronës me Nr. P-72514003-00002-0, P.sh 'Rrugët', me shfrytëzim rrugë e pakategorizuar, në sipërfaqe të përgjithshme të saj prej S=00.17.64 ha në Zonën Kadastrale Harilaç.

Pika e katërt (4) - Propozim për ndarjen e pagesave në këste të taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndarjen në këste të pagesave për taksat e ndërtimit', ftoi Shefen e Planifikimit Urban znj. Antigona Sahiti që të na jap sqarime.

Shefja e Planifikimit Urban: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kemi propozuar që pagesa e taksave të ndërtimit, të bëhet me këste, sepse tani do të kemi ndërtime në hapësira më të mëdha duke filluar nga një apo dy hektarë tokë, për këtë kemi paraparë që të kemi edhe garancionin bankarë, sepse kemi taksa të ndërtimit me shuma të mëdha deri në 580,000.00€, ne jemi të obliguar të respektojmë procedurat që janë 30 ditë, andaj duhet ta kemi garancionin bankarë, meqë kemi ndërtime të objekteve deri në 110.000 metra katërorë. Tani ndërtimi do të bëhet me blloqe të ndërtimit, andaj nevojitet që pagesa të bëhet me këste, njësoi veprojnë edhe në Komunën e Prishtinës.

Ali Ismaili: Këto taksa të ndërtimit kanë ndikim të madh në buxhet, andaj duhet të krijohen lehtësime për biznesin, në këtë rast për ndërtuesit, sikur edhe për bizneset tjera.

Naser Graiçevci: Këtu e kemi një propozim të mirë, që krijon lehtësime për bizneset, këtu kemi të bëjmë me investitor të mëdhenjë të ndërtimit, por duhet të kemi vëmendje tek garancionet bankare, biznesi më llagari këtu ka të hyn kredi, se sa ta marrë këtë garancion bankarë.

Driton Ademi: Këtë punë e ka arsyetuar Ekzekutivi i Komunës, por duhet të kemi kujdes me planifikimin e buxhetit, unë besoi se kjo punë është studiuar dhe analizuar drejtë dhe me kujdes nga Drejtoria e Planifikimit Urban, është në interesin e zhvillimit dhe duhet ta përkrahim.

Aida Alimi: Ne e përkrahim propozimin në fjalë dhe jemi për ndarjen e kësteve të pagesave për taksat e ndërtimit, për subjektet afariste që mirren më ndërtime të larta në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e kemi shqyrtuar dhe analizuar propozimin në fjalë dhe jemi për aprovimin e 'Propozimit për ndarjen në këste të pagesave të taksave të ndërtimit', meqë kjo praktikë ekziston edhe në komunat tjera, por vetëm duhet të kemi kujdes me garancionin bankarë.

Nënkryetari i Komunës: Tani bizneset do të kenë për pagesa taksa të mëdha, në shuma të larta të mjeteve financiare prej: 200.000.00€, andaj duhet të bëhet kjo ndarje në këste, sepse ka ndikim të madh edhe në rritjen e buxhetit të komunës. Këtë punë Komuna e Prishtinës e ka rregulluar para disa viteve, me Rregullore.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndarjen e pagesave në këste të taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për ndarjen e pagesave në këste të taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukturë' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 298, të datës 21.05.2021, për ndarjen e pagesave në këste të taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në Infrastrukturë.

Pika e pestë (5) - Propozim për marrjen e vendimit për fillimin e procedurës për themelimin të dy institucioneve të arsimit parauniversitarë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e dy institucioneve parauniversitare në Komunën e Fushë-Kosovës', të gjithë e dimë se Shkolla Filllore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, është e stërngarkuar me nxënës, tani ajo i ka rreth tre mijë e katërqind nxënës dhe është propozuar që të themelohen dy shkolla të reja në lagjen e Dardanisë dhe Apollonisë në Fushë-Kosovë, me nga një mijë nxënës secila. Hap diskutimin.

Migjen Kolshi: Ne në parim jemi për themelimin e dy institucioneve të reja parauniversitare në Fushë-Kosovë, për kërkojmë disa sqarime shtesë për këtë proces, sikur edhe dihet në Drejtorinë e Arsimit ka shumë probleme, edhe Udhëheqësi i ri i Drejtorisë së Arsimit z. Adnan Bullatovci ka dhënë dorëheqje. Vendimi për ndërtimin e shkollës në tokën e marrë me kompensim ninë e ë bonuse të ndërtimit për Kompaninë 'Al Trade', është kthyerë në rishqyrtim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por nuk është shfuqizuar asnjëherë në Kuvendin e Komunës.

ne këtu e kemi një listë për drejtor, zëvendësdrejtor dhe mësues për secilën shkollë, por nuk kemi norma për plotësimin e këtyre vendeve të punës, këto punë janë të përkohëshme aty për aty, sepse mungon planifikimi për zhvillimin e arsimit.

Durim Hajra: Unë pajtohem me mendimin e parafolësit tim anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi, nevoja për shkolla të reja në Fushë-Kosovë është shumë e madhe, por nga komuna ka mungur një planifikimi i mirëfilltë i zhvillimit të arsimit me vite të tëra, ne do të kemi probleme me norma për mësues të ri, secilës shkollë i duhet edhe stafi mbështetës. Ne jemi për themelimin e dy institucioneve të reja parauniversitare, por ky proces i punës duhet të jetë i kordinuar edhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Driton Ademi: Unë insistoi që përgatitjet për themelimin e këtyre dy shkollave të jenë të mira, ne jemi në fund të mandatit tonë dhe duhet të jemi parimorë në qëndrimet tona, unë në këtë rast do ta bëjë një përjashtim, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale është në përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës, që të krijoj kushte për arsimin fillor dhe të mesëm, andaj unë do të votoi për shkarkimin e arsimit në rastin konkret. Në arsim duhet të krijohet një master-plan për zhvillimin e tij, edhe sa i përket infrastrukturës edhe pjesës edukativo-arsimore.

Aida Alimi: Ne jemi për themelimin e dy institucioneve të reja parauniversitare në Komunën e Fushë-Kosovës, sepse nevoja për themelimin e tyre është e madhe, por ne në fillim të mandatit ua kemi tërhequr vërejtjen dhe kemi kërkuar një regjistrim të brendshëm të popullsisë, për të evituar këto probleme në arsim, në këtë kontekst kemi patur edhe gjetjet e auditimit të jashtëm, të cilat nuk janë marrë parasysh më kohë, andaj jemi në këtë gjendje të pafavorshme.

Nënkryetari i Komunës: Pajtohem me mendimin e parafolësve të mi anëtarëve të Kuvendit të Komunës: Durimit dhe Dritonit, se ne kemi probleme me norma për mësues të ri në arsim, ne do të kërkojmë me rishikimin e buxhetit norma të reja për mësues, por ju duhet ta dini se ne duhet të gjejmë zgjidhje për arsim, atje i kemi tre mijë e katërqind nxënës tani, ku numër deri në shtator do të rritet edhe më shumë, andaj ju e keni propozimin përpara vetës për themelimin e dy institucioneve të reja arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës.

Sabit Bullatovci: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Ju këtë propozim nuk duhet ta shihni në aspektin politikë, në komunat tjera janë duke u mbyllur shkollat, ndërsa të ne për arsye të zhvillimit të hovshëm dhe migrimit të popullsisë në qytetin tonë, ne i kemi edhe nga dyzet e pesë nxënës në një klasë dhe duhet të themelohen edhe këto dy institucione të reja arsimore. Këtu si anëtarë të Kuvendit të Komunës duhet të jemi njëzëri, sepse janë njëmijë nxënës në shkollat që pritet të themelohen, kriteri kryesorë bazë numri i nxënësve është i plotësuar, e kemi edhe zbërthimin se si do të funksionon shkolla e re, andaj unë ju ftoi të gjithëve që ta përkrahim propozimin në fjalë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për themelimin e dy institucioneve parauniversitare në Komunën e Fushë-Kosovës, shkollave të reja në lagjen e Dardanisë dhe Apollonisë'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për themelimin e dy institucioneve parauniversitare në Komunën e Fushë-Kosovës, shkollave të reja në lagjen e Dardanisë dhe Apollonisë' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 407, të datës 28.05.2021, për themelimin e dy institucioneve të arsimit parauniversitarë në Komunën e Fushë-Kosovës, me përshkrimin dhe strukturën si vijon:
 - 1.1 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në lagjen e Dardanisë, me tridhjetë (30) paralele dhe me njëmijë nxënës;
 - 1.2 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në lagjen e Apollonisë në anën e djathtë të rrugës magjistrale M9, me tridhjetë (30) paralele dhe me njëmijë nxënës.
2. Kryerja e çështjeve tjera, mbikëqyrja, strukturimi dhe sistemimi i personelit arsimorë, administrativ, teknik dhe sigurimi i objekteve shkollore për realizimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për vendosjen e një kontejneri në hapësirën e parkingut në oborrin e komunës për Postën e Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për vendosjen e një kontejneri në hapësirën e parkingut në oborrin e komunës për Postën e Kosovës', me qëllim të ofrimit të shërbimeve postare sa më afër për institucionet e komunës dhe qytetarët. Hap diskutimin.

Nënkryetari i Komunës: Meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me një Kompani Publike në nivel vendi, ne jemi për dhe pajtohemi me vendosjen e këtij kontejneri në hapësirën e parkingut në oborrin e komunës.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për vendosjen e një kontejneri në hapësirën e parkingut në oborrin e komunës për Postën e Kosovës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për vendosjen e një kontejneri në hapësirën e parkingut në oborrin e komunës për Postën e Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 529, të datës 25.05.2021, për vendosjen e një kontejneri në hapësirën publike të parkingut në oborrin e Komunës së Fushë-Kosovës, për Kompaninë publike Postën e Kosovës sh.a, për krijimin e lehtësimeve administrative të marrjes së shërbimeve publike, për qytetarët dhe institucionet komunale.

Pika e shtatë (7) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Remzi Shala: Ne e kemi një kërkesë edhe të personelit shëndetësorë që kontejnerët e mbeturinave, të vendosur në oborrin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, të zhvendosen në një lokacion tjetër.

Driton Hasolli: Unë të ndëruar/a anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dje, e kam inicuar për aprovim 'Propozimin për kompensimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës të prekur me virusin Covid - 19', të cilët nuk kanë patur

mundësi pa vullnetin e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit dhe Kuvendit, meqë mbledhjet e Kuvendit të Komunës nuk janë organizuar online në kohën e pandemisë nga komuna. Ju e nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, duhet ta vendosni në procedurën e votimit rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Driton Ademi: Meqë i kemi mbi pesë mijë raste të prekur me virusin Covid – 19 deri tani në Komunën e Fushë-Kosovës, për mendimin tim ne nuk kemi të drejtë morale të kërkojmë kompensim, kur nuk janë kompensuar as qytetarët e komunës. Mbledhjet nuk mund të organizohen, edhe online, edhe me prani fizike në të njëjtën kohë, këtu ne jemi një numër i vogël, andaj unë jam kundër.

Remzi Shala: Unë dua të jem korrekt me të gjithë, ne duhet të jemi solidarë edhe me qytetarët e prekur me virusin Covid - 19, ku një pjesë e tyre sigurisht se e kanë gjendjen e vështirë ekonomike dhe sociale, andaj nuk duhet ta kërkojmë as ne këtë kompensim, që na takon edhe neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës, duhet ta kemi një mirëkuptim në rastin konkret.

Nënkryetari i Komunës: Unë pajtohem plotësisht me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi, se nuk duhet ta kompensohen për mospjesëmarrje në mbledhje anëtarët e Kuvendit të Komunës, meqë nuk kemi mundësi financiare t'i kompensojmë mbi pesë mijë qytetarë të prekur me virusin Covid - 19.

Driton Ademi: Këtu ne jemi të thirrur t'i mbrojmë interesat e publikut, jo vetën, andaj unë jam që ky propozim të mos hidhet në votim, për arsye që të gjithë i dijmë.


Sabit Bullatovci: Ne nuk kemi mundur t'i kompensojmë qytetarët, që kanë patur shpenzime të mëdha në përballje me virusin, nuk janë kompensuar as punëtorët shëndetësorë si duhet, kompensimi duhet të bëhet vetëm nëse lejohet me ligj dhe rregullore, ne nuk duhet të kërkojmë kompensim për vetën, kjo punë është e rregulluar me udhëzimin administrativ për pagesa shumë qartë, ne nuk mund të veprojmë ndryshe, edhe pse jemi të dëmtuar në aspektin financiarë, prioritet për ne duhet të jetë ndihma për qytetarët.

Migjen Kolshi: Kompensimin e mëditjeve për pjesëmarrje në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, nuk e kemi marrë as muajin e kaluar, sepse ne nuk kemi marrë pjesë në aprovimin e raportit financiarë për buxhetin e shpenzuar.

Durim Hajra: Ne kërkojmë që institucionet e komunës të jenë më serioze në veprimet e tyre, që po i ndërmarrin në arsim dhe shëndetësi, kemi anulim të konkurseve pa ndonjë arsye serioze procedurale dhe përmbajtësore, këto fusha janë të ndieshme, andaj duhet të kemi kujdes se si po veprojmë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:40 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

